



## Titulli i projektit

Rritja e cilësisë së menaxhimit të mbetjeve dhe shtrirja e tij në një territor më të gjerë në ZF Lezhë

## Tipi i projektit

Shërbime publike

## Vendndodhja e projektit

Zona Funksionale Lezhë

## Buxheti i paravlerësuar

1,16 milionë Euro

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Bashkia Lezhë dhe një pjesë e komunave të tjera përbërëse të Zonës Funksionale Lezhë ofrojnë shërbimin e pastrimit në nivele të ngjashme. Bashkia Lezhë (aktuale) ka edhe një plan të menaxhimit të mbetjeve, ndërkohë që ky i fundit duhet të shtrihet edhe për zonat e tjera. Gjithashtu, është e nevojshme të bëhet edhe shtrirja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në një territor më të gjerë të Qarkut Lezhë. Një plan i menaxhimit të mbetjeve për Qarkun Lezhë është përgatitur me mbështetjen e IPA, ku parashikohen procedurat për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; inventari i vend-depozitimeve ekzistuese dhe gjendjes e nevojave për rehabilitim, si edhe mekanizmat e nevojshëm për rritjen e të ardhurave. Këtu veçohet nevoja për vazhdimin e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonën e Lezhës, si edhe një sistem grumbullimi në nivel qarku, duke krijuar qendra transferimi për të ulur kostot.

## Qëllimi/et specifik të projektit

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në zonën e Lezhës;
- Inkurajimi i mbledhjes së diferencuar dhe ndërtimi i një stacioni transferimi për uljen e kostove;
- Përmirësimi i situatës mjedisore në zonën e Lezhës dhe respektimi i standardeve ligjore për menaxhimin e mbetjeve;
- Mbështetje për sektorin e turizmit

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Përfituesit direktë të projektit janë e gjithë popullsia banuese e Zonës Funksionale Lezhë (66536 banorë); si edhe vizitorët e shumë gjatë periudhës së verës. Në mënyrë indirekte, projekti favorizon bizneset e Lezhës dhe sidomos ato të lidhura me turizmin. Bashkia Lezhë është njëkohësisht zbatuese/partnere dhe përfituese e projektit.



## Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e projektit është 5 vjet dhe përfshin:

- Krijimin e të dhënave bazë për menaxhimin e integruar të mbetjeve për zonën funksionale Lezhë (ekzistojnë për bashkinë ekzistuese Lezhë);
- Zgjerimi i planit vendor të menaxhimit të mbetjeve;
- Shtirja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve përtej kufijve të sotëm të bashkisë Lezhë;
- Studimi i fizibilitetit për stacionin e transferimit Lezhë;
- Ndërtimi i stacionit të transferimit Lezhë;
- Fushatë ndërgjegjësimi

## Maturimi i projektit

Projekti është pjesërisht i pjekur. Koncept-ideja vjen si rezultat i studimeve dhe planeve për menaxhimin e mbetjeve në rajonin e Lezhës (Lezhë/Shëngjin nga dldp; Qarku Lezhë nga IPA), të cilët synojnë drejt mbledhjes së diferencuar dhe riciklimit, si dhe theksojnë nevojën për një stacion transferimi të mbetjeve për të ulur kostot e transportit deri në vend-depozitim.

Projekti përfshin ndërtimin e një stacioni transferimi, i cili duhet të paraprihet me një studim fizibiliteti. Në varësi të rezultateve të studimit të fizibilitetit, mund të ketë nevojë edhe për ndërtimin e rrugëve të aksesit.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financuesit e mundshëm të projektit janë buxheti i shtetit (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës) dhe IPA, për shkak të ndjeshmërisë ndaj çështjeve mjedisore nga BE. Bashkia mund të bashkëfinancojë nëpërmjet përmirësimit të strukturës së të ardhurave dhe për fushatat e ndërgjegjësimit.

## Kostot e projektit

- Baza e të dhënave për mbetjet – 30,000 Euro;
- Zgjerimi i planit vendor të menaxhimit të mbetjeve – 30,000 Euro;
- Përmirësimi dhe shtirja e shërbimit jashtë kufijve të bashkisë Lezhë / blerje pajisjesh, automjeteve – 200,000 Euro
- Studimi i fizibilitetit për stacionin e transferimit Lezhë – 100,000 Euro
- Ndërtimi i stacionit të transferimit – 800,000 Euro